

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me objekt “Kontroll mbi gjendjen e mjedisit, monitorimi i treguesve të mjedisit, realizimi i tyre, problemet, analizat e shkaqeve dhe masat e marra, si dhe zbatimi i procedurave për dhënien e lejeve për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis” për periudhën 01.05.2009 deri 31.07.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 26 datë 05.03.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 341/7, datë 05.03.2012, dërguar Z. Fatmir Mediu, Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.

Duke referuar në Direktivën 2008/99/EC të Parlamentit dhe Këshillit Europian të datës 19.11.2008, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të marrë iniciativën për hartim të ndryshimit në kreun IV të Kodit Penal dhe ti përcjellë këto ndryshime në Këshillin e Ministrave për ushtrimin e nismës ligjvënëse.

A. Ligji ekzistues- Kreu IV

1. Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal.

KREU IV - Vepra penale kundër mjedisit

Veprimet e mëposhtme përbëjnë vepra penale, kur kryhen në mënyrë të paligjshme dhe me qëllim, ose të paktën me neglizhencë të theksuar:

Neni 201 - Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit përmes çlirimi të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive e bërë tej kufirit të normave të lejuara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet.

Neni 202 - Transportimi i mbeturinave toksike

Transportimi transit apo depozitimi në territorin shqiptar të mbeturinave toksike dhe radioaktive, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 203 - Ndotja e ujërave

Ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Neni 204 - Peshkimi i ndaluar

Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Neni 205 - Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Neni 206 - Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë

Prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Prerja e drurëve në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente, përbën kundërvajtje penale e dënohet me burgim gjer në tre muaj.

Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet dhe me gjobë nga 500,000 (pesë qind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milion) lekë. Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet me gjobë nga 500,000 (pesë qind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milion) lekë.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 1,000,000 (një milion) lekë deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë.

Neni 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor

Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 207 - Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve

Shkelja e rregullave për karantinën e bimëve apo të kafshëve, kur ka sjellë pasoja të rënda materiale ose që rrezikojnë jetën e shëndetin e njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Konkluzione dhe analizë

Së pari: Propozimi për ndryshim i Kreut IV që parashikohet në Kodin Penal, është shumë pozitive sepse në një mënyrë të përgjithshme vendos mekanizmat ligjore të mbrojtjes për disa nga agresionet më të rëndësishme kundër mjedisit.

Së dyti: Ka një sërë reformash që janë të nevojshme për të arritur në një mbrojtje më të mirë dhe më të plotë të mjedisit.

Së treti: Në veprat penale kundër mjedisit, kemi patur parasysh pasurinë juridike të mbrojtur dhe për këtë do të ishte e përshtatshme, që në gjitha figurat penale, të përfshihej si element objektiv i veprës penale krijimi i një situatë të rrezikshme për mjedisin dhe kjo pa qenë nevoja që të shkaktohet një dëm material.

Së katërti: Në veprat penale që i referohen specieve bimore ose kafshëve, duhet të vlerësoheshin në mënyrë penologjike, rastet në të cilat agresioni prek speciet e mbrojtura ose në rrezik shfarosje.

Së pesti: Duhet të futet një mbrojtje e veçantë për Parqet Natyrore dhe zonat e ngjashme.

Së gjashti: Është e domosdoshme të përfshihet një figurë penale për të dënuar veprën penale të gjuetisë së paligjshme.

Së shtati: Drejtimi që i referohet prerjes së pemëve dekorative dhe frutore nuk duhet të ishte e penalizuar, mbrojtja e këtyre specieve duhet të bëhej brenda hapësirës administrative.

Së teti: Rezultate të caktuara, si pakthyeshmëria e dëmit ose dëmi katastrofik, duhet të vlerësoheshin në mënyrë të përshtatshme duke vendosur një rrethanë të caktuar.

B. Propozimi për ndryshim

Kreu IV Neni 201-Ndotja e ajrit

Shkarkimi, çlirimi ose futja e një sasive materialeve ose rrezatimi jonizues në ajër, në ujë ose në tokë, e cila shkakton ose mund të shkaktojë vdekje ose dëmtim të rëndë të shëndetit të njeriut ose dëmtim të rëndë të cilësisë së ajrit, **tokës ose ujit, ose të kafshëve dhe bimëve**, ndotja e ajrit përmes çlirimit të tymrave, gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive e bërë tej kufirit të normave të lejuara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.

Argumentimi

Së pari: Ky nen vendos një figurë bazë dhe një nënfigurë në rrethana të rënduara. Në ligjin ekzistues vepra penale e ndotjes së ajrit kërkon elementët e mëposhtëm:

- ndotjen e ajrit;
- që kjo ndotje të jetë shkaktuar nga çlirimi i tymrave, gazrave ose substancave të tjera radioaktive;
- që shkarkimet të tejkalojnë kufijtë normalë të lejuar.

Së dyti: Por përveç tre elementëve të mësipërm është e domosdoshme që të ekzistojë dhe një element i katërt: që drejtimi i përshkruar të mos të jetë shkelje administrative.

E drejta administrative sanksionuese luan një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, por për të proporcionuar një mbrojtje të përshtatshme është e nevojshme plotësimi i normativës së thënë me atë penale.

Së treti: Ligji nr. 8897, datë 19.05.2002 “Mbi mbrojtjen nga ndotja të ajrit”, neni 19, tregon një sërë drejtimesh të sanksionueshme dhe thotë se këto drejtime, kur nuk përbëjnë vepër penale do të përbëjnë shkelje administrative dhe konkretisht:

- i. sanksionohen një sërë veprimtarish të parashikuara në nenin 17 të ligjit, kur kryhen veprimtari pa pasur autorizimin përkatës mjedisor;
- ii. në vijim konsiderohet shkelje administrative prodhimi ose tregtimi i lëndëve djegëse pa pasur kërkesat e cilësisë të aprovuara nga Qeveria;
- iii. sanksionohet përdorimi i lëndëve djegëse të ndaluara;
- iv. dënohet prodhimi dhe tregtimi i burimeve të ndotjes pa ju përmbajtur normativës së vendosur.

Së katërti: Deri këtu duket mjaft e qartë se cili është ndryshimi midis veprës penale dhe shkeljes administrative, e në mënyrë të dukshme qëndron në faktin që shkelja administrative nuk kërkon që të kryhet një shkarkim i vërtetë ndotës i cili të tejkalojë kufijtë normalë të lejuar, por që thjeshtë mjafton realizimi i një drejtimi, duke mos pasur lejet e përshtatshme ose duke mos ju përmbajtur normave të vendosura.

Me një renditje të gjerë të drejtimeve që përbëjnë shkelje administrative, ndryshimi midis paligjshmërisë penale dhe administrative nuk shfaqet shumë qartë.

Së pesti: Më i qartë duket redaktimi i nënfigurës në rrethana të renduara që thotë:

“Për të njëjtën vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim deri në 10 vjet”.

Këtu ka pak vështirësi. Gjithmonë kur një shkarkim ndotës është në gjendje të shkaktojë një dëm për jetën e shëndetin e njerëzve do të jetë një vepër penale.

Secila nga drejtimit e përshkruara në normën administrative që krijon këtë rrezik për qenien njerëzore, në mënyrë automatike do të pushojë që qeni shkelja administrative dhe do të jetë vepër penale. E në mënyrë evidente këtë duhet ta lidhim sërish me konceptin e pasurisë juridike të mbrojtur. Ashtu si dhe më përpara doli në pah se pasuria juridike e mbrojtur është mbrojtja e cilësisë mjedisore. Dhe kjo duhet plotësuar. Vizioni i mjedisit që proporcionon fushën penale është antropocentrik. Mjedisi është një vlerë e mbrojtur penalisht që nga momenti që është i vlefshëm nga perspektiva e njeriut.

Kështu, veprimet që venë në rrezik ose dëmtojnë mjedisin duhet që të dënohen, por ky dënim duhet të jetë më i madh kur vihet në rrezik jo vetëm mjedisi por gjithashtu kur vihet në rrezik jeta e njerëzve.

Konkluzion: Kjo duhet të jetë perspektiva që duhet adoptuar kur luftohet kundër kriminalitetit mjedisor dhe në rastin konkret, kjo perspektivë është adoptuar në ndryshimin e këtij neni për të rënduar dënimin në ato raste, kur agresioni mjedisor shkakton **dëmtim të rëndë të shëndetit të njeriut ose dëmtim të rëndë të cilësisë së ajrit, tokës ose ujit, ose të kafshëve dhe bimëve.**

Neni 202 - Grumbullimi, transportimi i mbeturinave toksike

Grumbullimi, transportimi, nxjerrja ose hedhja e mbeturinave toksike, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimtarive dhe kujdesin e mëpasëm të vendeve të hedhjes, duke përfshirë veprimet e ndërmarra në cilësinë e treguesit apo ndërmjetësit (menaxhimi i mbetjeve), që shkakton vdekje ose dëmtim të rëndë të shëndetit të njeriut ose dëmtim të rëndë të cilësisë së ajrit, tokës, ose ujit, ose të kafshëve dhe bimëve, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Argumentimi

Transportimi i mbetjeve, kur ky aktivitet bie në fushën e veprimit të nenit 2/35 të Rregullores (EC) No 1013/2006 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 14.06.2006, për transportin e mbetjeve dhe është kryer në sasi të konsiderueshme, si kur është kryer në një ngarkesë të vetme apo në disa ngarkesa që duket se janë të lidhura midis tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 202/a - Kryerja e aktivitetit me lëndë toksike

Funksionimi i një kompleksi në të cilin kryhet aktivitet i rrezikshëm ose në të cilin substanca ose preparate të rrezikshme ruhen ose përdoren dhe të cilat, jashtë kompleksit shkakton ose mund të shkaktojë vdekje ose dëmtim të rëndë të shëndetit të njeriut ose dëmtim të rëndë të cilësisë së ajrit, tokës ose ujit, ose të kafshëve dhe bimëve, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Argumentimi

Së pari: Kjo vepër penale shfaqet qartë dhe pa vështirësi të dukshme siç shtrihet ligji i mëparshëm.

Së dyti: Çdo drejtim që përbëhet nga grumbullimi, transportimi, nxjerrja ose hedhja e mbeturinave toksike.....që shkakton vdekje ose dëmtim të rëndë të shëndetit të njeriut, është një vepër penale.

Këtu nuk bëhet fjalë në parim aplikimi i normës administrative. Arsyeja gjithashtu është mjaft evidente. Rrezikshmëria e mbeturinave toksike dhe radioaktive dhe dëmshmëria për mjedisin është e qartë. Ka vetëm dy mundësi. Ose kur transporti i mbeturinave toksike realizohet me autorizim përkatës ose pa të. Me rastin e dytë shkaktohet një rrezik për sigurimin e mjedisit, e ndërkaq drejtimi penalisht është kuptimplotë dhe duhet të sanksionohet. Për sa i përket depozitimit, gjithmonë do të jetë e rrezikshme.

Kjo vepër penale ka një figurë në rrethana të rënduara ku ka pasoja për jetën dhe shëndetin e njerëzve. Konsideratat e bëra më parë në veprën penale të nenit 201, me ndryshimin e tij janë të zbatueshme.

Së treti: Në nenin aktual në këtë figurë penale dallohen qartë tre drejtime të dënueshme të ndryshme nga konfigurimi dhe struktura dhe konkretisht:

Struktura e drejtimit të parë: Konsiston në transportimin e mbeturinave toksike dhe radioaktive në territorin e Shqipërisë. Që të kryhet një vepër penale kundër mjedisit nuk është e nevojshme që të ketë ndonjë rezultat, mjafton vetëm fakti i thjeshtë i transportit. Nuk është gjithashtu e nevojshme që të ketë një situatë të një rreziku konkret. Kjo vepër penale konsiderohet nga doktrina si vepër penale e një rreziku abstrakt, ose është një vepër penale në të cilën nuk i përket karakteristikave të figurës, por ajo që ekziston është një prezumim që situata është e rrezikshme në vetvete.

Në këtë figurë të veprës penale ekziston vetëm një prezumim i thjeshtë i rrezikut. Drejtimi dënohet për faktin e thjeshtë se transportimi i mbeturinave toksike dhe radioaktive.... mund të shkaktojë një rrezik, por edhe nëse nuk e shkakton, vepra penale ekziston.

Struktura e drejtimit të dytë: të rregulluar në këtë figurë, është plotësisht e ndryshme, i referohet depozitimit të mbeturinave toksike dhe radioaktive. Kjo vepër penale tashmë nuk është prezumim i rrezikut, por është një rrezik real. Kjo vepër penale quhet nga doktrina rrezik konkret, sepse mundësia që të ketë një rezultat është i dukshëm. Domethënë, depozitimi i këtyre mbeturinave do të shkaktojë mjedisit në mënyrë të pashmangshme një dëm. Megjithatë duhet të themi se si në këtë supozim ashtu dhe në atë të mëparshmin, në kuadrin e veprave penale me rrezik, nuk është e duhur që të shkaktohet një dëm paraprak. Për konsumin e veprës penale mjafton fakti i thjeshtë i depozitimit.

Struktura e drejtimit të tretë: i përket një kategorie të ndryshme nga ajo e veprave penale të dëmit ose me rezultat. Kodi Penal dënon më rëndë, ato raste të cilat shkaktojnë pasoja të rënda për jetën ose shëndetin e njerëzve. Për ta zbatuar këtë nënfigurë është e domosdoshme që situata paraprake e rrezikut të jetë shndërruar në një situatë reale dëmi dhe si pasojë e transportit ose depozitimit të mbeturinave toksike ose radioaktive, të jenë shkakuar një sërë pasojash për jetën ose shëndetin e njerëzve.

Neni 203 - Ndotja e ujërave

Ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin **ose mund të prishin** ekuilibrin ekologjik, **me mbeturina spitalore, organike ose mbeturina urbane**, dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka shkakuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.

Argumentimi

Analiza e këtij neni gjithashtu nuk paraqet vështirësi. Elementët që përbëjnë veprën penale janë:

- një ndotje e çdo lloji të ujërave, ose qoftë një degradim i cilësisë së tyre;

- që ky degradim të prishë ekuilibrin ekologjik, ose që mund të dëmtojë seriozisht sistemet natyrore, qofshin kafshë ose bimë. Domethënë kërkohet që ti shkaktohet një dëm ekosistemit.

Në këtë rast, megjithëse është e rëndësishme që figura të përfshijë në termat e saj kërkesën që ndotja të prishë ekuilibrin ekologjik, besoj se është më efikase për mbrojtjen e mjedisit, të përparojë barrierën e dëmit në momentin e krijimit të rrezikut pa pritur rezultatin. Pra në këtë vepër penale është më se e domosdoshme të përfshihet fraza e shtuar në këtë nen.

Është e vërtetë se kemi forma jo perfekte për të dënuar këto drejtime kur nuk arrijmë që të shkaktojmë një rezultat, por do të ishte më efektive dhe më pak konfuze të avancojmë në mbrojtjen e pasurisë juridike paqenë nevoja për t'ju kthyer tentativës.

Ka një aspekt tjetër i cili duhet të dali në pah nëse do të kritikojmë përmbajtjen e këtij neni. Ai rregullon ndotjen e ujërave me mbeturina toksike ose radioaktive. Në mënyrë të dukshme këto derdhje janë shumë të rrezikshme, por nëse jemi duke trajtuar temën e mbrojtjes së mjedisit do të ishte e nevojshme të rregullohej në Kodin Penal, ndotja **me mbeturina spitalore, organike ose mbeturina urbane**. Një derdhje e këtyre të fundit mund të sjellë shkatërrimin e një ekosistemi njësoj si një derdhje e mbeturinave toksike ose radioaktive.

Neni 204 - Peshkimi dhe gjuetia e ndaluar

Peshkimi në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara **si dhe gjuetia** përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer **në dy vjet**.

Peshkimi i kryer me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

Argumentimi

Në këtë nen mbrohen speciet e detit dhe sanksionohet peshkimi i tyre, kur realizohet në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

- kur peshkohet në kohë dhe vende të ndaluara;
- kur peshkohet me mjete të ndaluara;
- kur peshkohet me mjete të rrezikut të përbashkët.

Pjesa e parë e drejtimit synon të ruaje speciet e detit në kohë dhe në vende me cenueshmëri ose me rrezikshmëri më të madhe për mbijetesën e tyre ashtu si dhe të reduktojë kapjen e tyre gjatë një periudhe kohe që konsiderohet e nevojshme për ruajtjen e tyre. Si përmbledhje, ajo që pretendohet është të kontrollohet mbijetesja dhe mbiekzistenca e specieve të detit duke evituar peshkimin e tyre të pa kontrolluar dhe abuziv.

Pjesa e dytë e drejtimit synon në të njëjtën kohë mbrojtjen e llojeve kur ndalohej peshkimi me metoda që janë të ndaluara. Që logjikisht janë ato të cilat për mungesën e selektimit ose për agresivitetin e tyre venë në një rrezik të madh jo vetëm mbijetesën e një lloji por të shumë llojeve.

Pjesa e tretë e drejtimit është një agravim i përdorimit të metodave të ndaluara. Në këtë rast sanksionohet më rëndë peshkimi duke përdorur disa metoda veçanërisht të rënda jo vetëm për llojet e peshqve por gjithashtu për vetë ekosistemin. Arsyeja e rëndësisë është karakteri katastrofik që mund të kenë këto teknika ilegale të peshkimit.

Me ligjin në fuqi kemi një surprizë, por kjo nuk është e lidhur me veprën penale të peshkimit të paligjshëm, **por se ligjvënësi ka harruar të vendosë normën paralele në të cilën dënohet vepra penale e gjuetisë së paligjshme**.

Neni 205 - Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, **ose të jenë dëmtuar Parqet Natyrore ose zonat e ngjashme me to ose mund të vërë në rrezik**

ekosistemin, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga **dy vjet deri në pesë vjet**.

Analizë

Një nga agresionet më të mëdha mjedisore që po vuan vendi ynë është prerja e pakontrolluar e pyjeve. Fakti i thjeshtë i prerjes në mënyrë të paligjshme (pa autorizim ose në kohën e vendin e ndaluar) do të përbëjë një vepër penale kur nuk përbën një shkelje administrative. Këtu duhet të kemi parasysh atë që thuhej më përpara mbi pasuritë juridike të mbrojtura. Nga pikëpamja tonë duhet të jetë një vepër penale vetëm kur prerja e paligjshme mund të vërë në rrezik ekosistemin, gjë e cila do të ndodhë vetëm kur si pasojë e prerjes shkatërrohen ato vende ose vendndodhje që nga karakteristikat e tyre të kenë një rëndësi nga pikëpamja mjedisore. Në të njëjtën kohë do të konsiderohen si vepra penale ato drejtime që për shtrirjen e tyre të dëmshmerisë së shkaktuar supozojnë një çrregullim serioz të ekuilibrit të ekosistemit.

Neni 206 - Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë (të revokohet)

Prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i ullishteve dhe parqeve nëpër qytete përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë. Prerja e drurëve në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente, përbën kundërvajtje penale e dënohet me burgim gjer në tre muaj.

Argumentimi

Në nenin 206 të Kodit Penal paraqiten dy drejtime që realisht nuk kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, tashmë që pasuria juridike e mbrojtur nuk është ekosistemi e as burimet natyrore, por pasuri të tjera, që kanë nevojë për mbrojtje.

Së pari: është thjeshtë një drejtim i atentatit kundër pronës. Fakti i shkakimit të një dëmi në objekte të caktuara dënohet me gjobë. E vetmja që mbron vepra penale është vlera e ulët ekonomike e produktit të dëmtuar. Pemët dekorative, nuk mund të kenë kurrë konsideratën e elementëve të integruar në një ekosistem, kryesisht nga artificialiteti i tyre. Një dëm i shkaktuar në një nga këto pemë dekorative është i dënueshëm vetëm për koston e saj ekonomike por jo për vlerën e saj mjedisore, sepse mund të flitet për një ekuilibër natyror në mes sistemeve.

Së dyti: në drejtim të parë dënohet gjithashtu shkaktimi i dëmit në ullishte ose parqe e cila rezultojnë dhe më ekstravagante në një kapitull të dedikuar mbrojtjes së mjedisit. Dëmtimi i kopshteve dhe parqeve duhet të dënohet, por vetëm si vepër penale e dëmshme, por jo si krim ekologjik. Ky drejtim nuk ka të bëjë fare me mbrojtjen e vlerave mjedisore.

Për sa i përket drejtimit të dytë, ose dëmtimit të drurëve frutorë, ullishtave e vreshtave, nuk paraqitet e justifikuar përfshirja e saj në Kodin Penal.

Arsyet për të cilat ligjvënësi vendosi që të përfshijë këtë drejtim në Kodin Penal **nuk shfaqen mjaft qartë dhe më e rekomandueshmja do të ishte heqja e saj**, prandaj kemi rekomanduar **të revokohet** ky nen.

Konkluzion: Më e drejtë do të ishte që për rastet e dëmtimit të drurëve frutorë, ullishtave e vreshtave si dhe për rastet e djegies së tyre si shkak të mos të pastrimit të tyre nga bari, barishtet e këqija, ferrat etj. të propozohet që tu hiqet pronarëve aktualë nga pronësia pronat e përfituara nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin e pronësisë pa shpërblim të tokës bujqësore” dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”.

Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor

Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet dhe me gjobë nga 500,000 (pesë qind mijë) lekë deri në

1,000,000(njëmilion)lekë.

Po kjo vepër, e kryer me qëllim ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet me gjobë nga 500,000 (pesë qind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milion) lekë.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 1,000,000 (një milion) lekë deri në 2,000,000 (dy milionë) lekë.

Neni 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor

Shkatërrimi apo dëmtimi nga pakujdesia, me pasoja të rënda materiale, i fondit pyjor, i fidanishtes pyjore, i grumbullit pyjor ose i çdo njësie të ngjashme me to, me zjarr, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve apo shkakton dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 207 - Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve

Shkelja e rregullave për karantinën e bimëve apo të kafshëve, kur ka **sjellë pasoja të rënda për faunën dhe florën**, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.

Argumentimi

Ky drejtim i fundit gjithashtu nuk duhej të ishte përfshirë në kapitullin e mjedisit. Kjo vepër penale ka si qëllim mbrojtjen ekskluzive të shëndetit të njerëzve dhe nuk ka lidhje fare me mbrojtjen e mjedisit.

E vetmja gjë që duhet të kuptohet është vendosja e saj korrekte që nga perspektiva tek karantina mund të shkaktonte pasoja për faunën dhe florën. Ndoshta, kur ligjvënësi përmend pasojat materiale, duhet të qartësonte se i referohej pasojave për speciet bimore ose kafshët. Në çdo rast figura kërkon një sërë modifikimesh, jo vetëm duke qartësuar këtë koncept “të pasojave materiale” por duke theksuar se këto pasoja duhet të prekin ekuilibrin ekologjik. Në të njëjtën mënyrë duhet të vlerësonte më rëndë ato raste në të cilat dëmi i shkaktuar dëmton speciet e mbrojtura ose në rrezik shfarosje.

Neni 208- Shkatërrimi i specieve të mbrojtura të florës.

Vrasja, shkatërrimi, posedimi apo marrja e mostrave të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër, përveç rasteve kur sasia e mostrave nuk është e konsiderueshme dhe ka një ndikim jo të madh në statusin e ruajtjes së specieve, Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër, përveç rasteve kur sasia e mostrave nuk është e konsiderueshme dhe ka një ndikim jo të madh në statusin e ruajtjes së specieve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 209- Shkatërrimi i zonës së mbrojtur.

Çdo veprim që shkakton përkeqësimin e theksuar të habitatit brenda zonës së mbrojtur, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 210- Dëmtimi i ozonit.

Prodhimi, importimi, eksportimi, nxjerrja në treg ose përdorimi i substancave që dëmtojnë ozonin, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet nga dy deri 5 vjet.

Argumentimi:

Së pari: Detyrimi që në zbatim të Direktivës 2008/99/EC të Parlamentit dhe Këshillit European të propozojmë disa ndryshime për përmirësime ligjore “Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal”.

Përvoja tregon se sistemi ekzistues i ndëshkimeve nuk ka qenë i mjaftueshëm për të siguruar respektimin e plotë të ligjeve, ku si pasojë e moszbatimit të tyre ka krijuar pasoja të pariparueshme në mbrojtjen e mjedisit. **Së dyti:** Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nuk ka përmirësim të ndjeshëm në zbatimin e sanksioneve ligjore ndaj akteve të kundërligjshme.

Së treti: Mungesa e Gjykatës Administrative ka influencuar mjaft negativisht në zbatimin e ligjit të mësipërm për vetë faktin e zvarritjes së vendimeve të Gjykatave dhe në shumë rrethe vendimet e gjykatave favorizojnë në mënyrë jo të drejtë individin dhe subjektet private.

KLSH rekomandon që ky proces të realizohet sa më shpejt mundësisht duke u bërë pjesë e procesit tashmë të nisur në Kuvend për ndryshimin në Kodin Penal.

2. Në zbatim të VKM nr. 396, datë 21.06.2006, pika 9, t’i propozohet Këshillit të Ministrave për shfuqizimin e të drejtës së përdorimit të pyjeve komunale për komunat e mëposhtme:

Rrethi Fier:

-Komuna Cakran, transferuar me VKM nr. 679, datë 21.05.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e zjarreve dhe nuk ka mbështetur në asnjë nga 5 rastet e zjarreve në pyjet që ka në pronësi kjo komunë.

Rrethi Delvinë:

- Komuna Mesopotam, transferuar me VKM nr. 755, datë 28.05.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e zjarreve dhe nuk ka mbështetur në asnjë nga 12 rastet e zjarreve të rëna në pyjet që ka në pronësi kjo komunë. Nuk ka ngritur skuadra vullnetare.

Rrethi Sarandë:

- Komuna Aliko, transferuar me VKM nr. 984, datë 02.07.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin zjarreve të rëna në pyjet që ka në pronësi kjo komunë.

Rrethi Tepelenë:

- Komuna Kurvelesh, transferuar me VKM nr. 571, datë 28.05.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e 11 raste zjarresh duke u djegur 300 ha pyje, që ka në pronësi kjo komunë.

- Komuna Lops, transferuar me VKM nr. 749, datë 28.05.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e 15 raste zjarresh duke u djegur një sipërfaqe prej 1000 ha pyje, që ka në pronësi kjo komunë.

- Komuna Qendër, transferuar me VKM nr. 663, datë 21.05.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e 33 raste zjarresh duke u djegur 890 ha pyje dhe kullotë, që ka në pronësi kjo komunë.

Rrethi Vlorë:

- Komuna Horë-Vranisht, transferuar me VKM nr. 175, datë 13.02.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e 16 raste zjarresh duke u djegur 129 ha pyje.

- Komuna Brataj, transferuar me VKM nr. 590, datë 14.05.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e dy rasteve zjarresh në pyje dhe kullota duke përkrahur 6,5 ha dhe djegur 6 ha.

- Komuna Qendër, transferuar me VKM nr. 754, datë 28.05.2008.

Nuk ka marrë masa për parandalimin e dy rasteve zjarresh duke u përkrahur 4,1 ha dhe djegur 0,8 ha pyll pishe.

Argumentimi:

Në komunat e mësipërme, rastet e zjarreve janë shkaktuar nga pakujdesia (neglizhenca) njerëzore dhe mangësitë për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota, ka konsistuar në katër drejtime kryesore:

Së pari: Mosmarrja e masave parandaluese, që konsistojnë në zbërthimin dhe programimin e masave të përcaktuara në “Planin kombëtar të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve dhe shpërndarjen e tij për zbatim në strukturat e varësisë”.

Së dyti: Angazhimi i pamjaftueshëm i strukturave të komunave në nxitjen dhe mobilizimin e komunitetit për shuarjen e zjarreve si dhe planifikimi i masave që duhet të marrë vetë komuna për mbrojtjen e pyjeve e kullotave brenda territorit të saj administrativ.

Së treti: Mos ngritja e sistemit të vrojtimit sinjalizimit, për një zbulim të shpejtë të vatrave të zjarreve dhe ndërhyrja në një kohë së më të shkurtër në rastet e zjarreve në pyje.

Së katërti: Bashkëpunimi dhe bashkërendimi mjaft i dobët i punës midis institucioneve shtetërore në nivel lokal, si dhe aktorëve të tjerë si përdorues, pronarë dhe subjektet private.

3. Për sipërfaqen e gjelbër të parkut të Pallatit të Brigadave prej 68 ha, që është në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Parkun e Liqenit në qytetin e Tiranës me një sipërfaqe prej 1,119,437 m², të përgatitet projektvendimi dhe t’i kërkohet Këshillit të Ministrave t’u jepet statusi i “Zonës së Mbrojtur” me motivacion “Park me destinacion rekreativ”.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me ministrinë e tjera të merren të gjitha masat tekniko organizative për të shpejtuar realizimin e nënplikave:

- MT2.1- Hartimi i planeve prioritare për administrimin e pyjeve dhe kullotave në zonat e larta malore;

- MT2.3 - Inventarizimi i zonave më të prekura dhe caktimi i prioriteteve për aplikimin e sistemit të thjeshtuar, të planeve për administrimin e pyjeve;

- MT2.4 - Hartimi në bashkëpunim i planeve për administrimin e pyjeve të thjeshtuar prioritar, për zonat me prioritet, përfshirë përgatitjen e qëllimeve të projektit për masat urgjente të rehabilitimit, për praktikën e përdorimit të burimeve pyjore dhe kullimore; si dhe:

- MT3.1 - Përfshirja e masave për minimizimin e erozionit të tokës në Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore;

- MT3.2 - Nxitja e masave që rekomandohet nga KPMB në zonat më shumë të prekura dhe,

- MT3.3 - Inventarizimi i zonave shumë të prekura në rajonin fushor dhe caktimi i prioriteteve për përgatitjen dhe paraqitje për miratim të projekteve për rehabilitimin e tyre; për të bërë më të plotë realizimin e studimit për zonat e ulta fushore dhe për realizimin e tyre sipas SNM-së.

Trajtuar në faqen 2 dhe 3, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Brenda muajit prill 2012

2. Të bashkëpunohet me ministrinë e linjës, në lidhje me zbatimin e masave të parashikuara në SNM në paragrafin 2.4.4 “Administrimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore e kullimore”, sipas pikave:

- AQP1-Mbrojtja dhe rehabilitimi i vazhdueshëm i pyjeve;

- AQP3-Ruajtja e natyrës dhe promovimi i ekoturizmit;

- AQP4-Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm dhe multifunksional të burimeve pyjore dhe kullimore;

- AQP5-Inkurajimi i aktiviteteve private;

- AQP8-Vazhdimi i reformës institucionale me qëllim krijimin e strukturave sa në efektive dhe të përshtatshme në qendër dhe në bazë.

Trajtuar në faqen 4, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

3. Nga MMPAU në bashkëpunim me institucionet përkatëse qendrore dhe vendore, të merren masa për programimin dhe implementimin e rezultateve dhe rekomandimeve të monitorimeve të dërguara nga institucionet përkatëse në zbatim të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, trajtuar në faqen 8 dhe 9, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

4. Të merren të gjitha masat tekniko-organizative për ngritjen e Komisioneve Konsultative Lokale të Peshkimit dhe të hartohet rregullorja e funksionimit të tyre, në zbatim kjo të nenit 6, të ligjit nr. 7908, datë 05.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar dhe nenit 3 të Rregullores nr. 1, datë 29.03.2005, e cila përcakton qartë edhe qarqet në të cilat duhet të ngrihen dhe funksionojnë këto komisione, trajtuar në faqen 17, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Brenda muajit prill 2012

5. Drejtoria e Biodiversitetit të sigurojë informacion të plotë për çdo Zonë të Mbrojtur, mbi mënyrën e menaxhimit dhe administrimit të tyre, mbi bazën e të cilit të kryejë hartimin dhe miratimin e planeve të menaxhimit për plotësimin e kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore për çdo zonë të mbrojtur dhe sidomos për ato zona që janë ngritur komitetet e menaxhimit, trajtuar në faqen 29,30, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Brenda muajit qershor 2012

6. Nga Drejtoria Juridike në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e tjera të hartohet rregullore e re e funksionimit të “Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Lejet Mjedisore dhe Peshkimit”, me qëllim që të kontribuojë në lehtësimin dhe shpejtimin e punës së Komisionit në procesin e pajisjes së subjekteve me leje mjedisore dhe të peshkimit, duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e çdo drejtorie dhe punonjësi në zbatim të akteve ligjore, nënligjore, urdhrave dhe udhëzimeve të nxjerra nga Ministri dhe që kanë detyrime për zbatimin e tyre.

Brenda muajit prill 2012

7. Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të rishikojnë mundësinë e përbërjes së Komisionit të kërkesave për lejet Mjedisore me tendencë në uljen e numrit të tij në zbatim të urdhrit të Ministrit me nr. 468, datë 25.05.2011 “Për ngritjen e komisionit të kërkesave për Lejet Mjedisore dhe Peshkimit”, trajtuar në faqen 33-48, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Brenda muajit prill 2012

8. Nga Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit, shqyrtimi i kërkesave për Leje Mjedisore të kryhet duke marrë mendimin nga ARM-të, të cilat në çdo rast duhet të përmbushin kërkesat ligjore për propozimin e kushteve sipas llojit të aktivitetit të subjektit, teknologjinë e përdorimit, kushtet teknike, vendndodhjen, rehabilitimin në zbatim të gjithë legjislacionit të mjedisit, për tu përfshirë në lejen mjedisore, trajtuar në faqen 33-48, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

9. Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në zbatim të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e

Shqipërisë”, VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” dhe urdhrin të Ministrit me nr. 429, datë 17.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për pajisjen me leje mjedisi në kuadër të Qendrës Kombëtare të licencimit”, të hartojnë një rregullore ku të përcaktohen marrja dhe ruajtja në formë të dokumentuar dhe elektronike për të gjithë kërkesat e paraqitura nëpërmjet QKL (Leje Mjedisore, Autorizime dhe Pëlqime Mjedisore).

Brenda muajit mars 2012

10. Në Drejtorinë e Mbrojtjes së Mjedisit, funksionimi i strukturës ekzistuese nuk i përgjigjet realizimit në kohë detyrave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të politikave dhe teknike për të marrë, trajtuar, analizuar dhe relatuar në kohë të dhënat që merren nga QKL. Vetë numri i ulët i punonjësve me numrin e hyrjes në QKL të dosjeve për leje mjedisore ndikon në realizimin e një performance të ulët, trajtuar në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

11. Brenda strukturës organizative të Ministrisë të krijohet mundësia e vendosjes së një operatoreje në Drejtorinë e Mbrojtjes së Mjedisit, për të operuar në mënyrë elektronike me QKL dhe në mënyrë të vazhdueshme të krijojë arkivin e kërkesave dhe miratimit të Lejeve Mjedisore, Autorizimet dhe Pëlqimet Mjedisore, duke krijuar “DATABASE” për gjithë kërkesat e vitit ushtrimor dhe në mënyrë graduale të plotësohet me kërkesat e viteve të mëparshme, trajtuar në faqet 33-48, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

12. Nga Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit, Sektori i VNM-së dhe lejeve për të gjitha subjektet që shfrytëzojnë burimet minerare përfshirë edhe guroret dhe shfrytëzimin e inerteve të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në METE, sipas kushteve dhe fondeve të planifikuara për rehabilitimin e mjedisit, trajtuar në faqet 48, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

13. Në kontrollet e kryera nga Inspektorët e Mjedisit të forcohet bashkëpunimi me strukturat e Pushtetit Vendor, ku përfaqësuesit e tyre të jenë pjesëtarë në grupet e punës të ngritura nga strukturat e MMPAU, veçanërisht strukturat e INUK dhe Taks Forcës që drejtohen nga Prefektët, trajtuar në faqet 63-81, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

14. Për subjektet që kanë ndikim në mjedis dhe rezultojnë të pa pajisura me leje mjedisore dhe për gjobat e vendosura të krijohet “DATABASE”, trajtuar në faqet 74-81, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

Vazhdimisht

C. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, germa a

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore.

- Për mosmarrje të masave në drejtim të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit në paragrafin 2.4.4. “Administrimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore e kullosore”.

a. Për mungesë bashkëpunimi me ministritë e linjës, në lidhje me zbatimin e masave të parashikuara në SNM në paragrafin 2.4.4 “Administrimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore e kullosore” dhe konkretisht:

- AQP.1- Mbrojtja dhe rehabilitimi i vazhdueshëm i pyjeve;
- AQP.3- Ruajtja e natyrës dhe promovimi i ekoturizmit;
- AQP.4 - Nxjitja e përdorimit të qëndrueshëm dhe multifunksional të burimeve pyjore dhe kullosore;
- AQP.5 - Inkurajimi i aktiviteteve private;
- AQP.8 - Vazhdimi i reformës institucionale me qëllim krijimin e strukturave sa më efektive dhe të përshtatshme në qendër dhe në bazë.

b. Për mungesë bashkëpunimi me institucionet përkatëse qendrore dhe vendore, për programimin dhe implementimin e rezultateve dhe rekomandimeve të monitorimeve të dërguara nga institucionet përkatëse në zbatim të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.

(Trajtuar në faqet 4,8 dhe 9, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit).

2. Për [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i Drejtorisë Peshkimit.

a. Për mungesë të ngritjes së Komisioneve Konsultative Lokale, në kundërshtim me nenin 6, të ligjit nr. 7908, datë 05.04.1995 “Për peshkimin”, i ndryshuar dhe nenin 3 të rregullores nr. 1, datë 29.03.2005, e cila ka dalë në zbatim të ligjit të mësipërm.

b. Për mungesë të ngritjes së Komisionit të Kërkimit Shkencor dhe Teknologjik, si strukturë e përcaktuar në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 7908, datë 05.04.1995 “Për peshkimin i ndryshuar” dhe me nenin 5 të rregullores nr. 1, datë 29.03.2005 e cila ka dalë në zbatim të ligjit të mësipërm.

(Trajtuar në faqen 17, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit).

“Kalimi në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një periudhë 1 vit”

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i Drejtorisë së Biodiversitetit.

a. Për mosmarrje të masave në drejtim të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsëktoriale të Mjedisit në paragrafin 2.4.1.5 “Mbrojtja e tokës” dhe paragrafin 2.4.4. “Administrimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore e kullosore” dhe konkretisht:

- MT2.1- Hartimi i planeve prioritare për administrimin e pyjeve dhe kullotave në zonat e larta malore;
- MT2.3 - Inventarizimi i zonave më të prekura dhe caktimi i prioriteteve për aplikimin e sistemit të thjeshtuar, të planeve për administrimin e pyjeve;
- MT2.4 - Hartimi në bashkëpunim i planeve për administrimin e pyjeve të thjeshtuar prioritar, për zonat me prioritet, përfshirë përgatitjen e qëllimeve të projektit për masat urgjente të rehabilitimit, për praktikën e përdorimit të burimeve pyjore dhe kullosore;
- MT3.1 - Përfshirja e masave për minimizimin e erozionit të tokës në Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore;
- MT3.2 - Nxjitja e masave që rekomandohet nga KPMB në zonat më shumë të prekura;
- MT3.3 - Inventarizimi i zonave shumë të prekura në rajonin fushor dhe caktimi i prioriteteve për përgatitjen dhe paraqitje për miratim të projekteve për rehabilitimin e tyre, për të bërë më të plotë realizimin e studimit për zonat e ulta fushore dhe për realizimin e tyre sipas SNM-së;

- AQP.1- Mbrojtja dhe rehabilitimi i vazhdueshëm i pyjeve;
- AQP.3- Ruajtja e natyrës dhe promovimi i ekoturizmit;

- AQP.4 - Nxitja e përdorimit të qëndrueshëm dhe multifunksional të burimeve pyjore dhe kullimore;

- AQP.5 - Inkurajimi i aktiviteteve private;

- AQP.8 - Vazhdimi i reformës institucionale me qëllim krijimin e strukturave sa më efektive dhe të përshtatshme në qendër dhe në bazë.

b. Për moszbatim të pikës 1 dhe 2 të nenit 15, si dhe germën “c”, pika 1, të nenit 16 të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, për hartimin dhe miratimin e planeve të menaxhimit për të gjithë zonat e mbrojtura.

c. Për mungesë informacioni në lidhje me lejet e dhëna në drejtim të aktiviteteve në bujqësi, të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të MMPAU, paragrafi i III-të germa “i”.

(Trajtuar në faqet 2,3,4,8,9,24 dhe 28-30, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit).

2. ■■■ me detyrë përgjegjëse i Sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në Drejtorinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe në cilësinë e sekretarit të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për miratimin e Lejeve Mjedisore, për paaftësi dhe neglizhencë në drejtim të ushtrimit të detyrës dhe konkretisht:

a. Nuk janë firmosur protokollet e mbledhjeve me numër: 4,5,8, 11,12,13,19,21,22,24,25,26,35,37,38 nga ana e sekretarit ■■■ për vitin 2010 dhe me numër: 1,3,5,6,9,22,25,26 për vitin 2011, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 25 pika 1 e Rregullores nr. 340, datë 11.6.2007 “Për procedurat e pajisjes me leje mjedisore”, trajtuar në faqen 32, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

b. Në shumë raste në relacionet e bëra në mbledhjet e komisionit të shqyrtimit të kërkesave për pajisje me leje mjedisore, ka dezinformuar komisionin, duke ndryshuar gjatë prezantimit objektin e aktivitetit që do zhvillojnë subjektet me qëllim miratimin e kërkesave për leje mjedisore, si dhe dezinformuar për vendndodhjen e objektit, duke çuar në zvarritjen e miratimit trajtuar në faqet 39-42, të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.

c. Në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të VNM dhe Lejeve, nuk ka organizuar studimin e dosjeve nga drejtoritë teknike, duke u përcjellë në formë elektronike kërkesat, dokumentacionin shoqërues dhe fletën e mendimit, të cilat duhet që brenda 5 ditë pune, të japin mendimin e tyre sipas formatit të fletës së mendimit dhe ja dërgojnë DMVNM.&L-së. Këto veprime bien në kundërshtim me pikat 5/g dhe 6, të urdhrin nr. 429, datë 17.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për pajisjen me leje mjedisi në kuadër të QKL-së”.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Pwllumb Beqiri, Edmond Gjini, Selman Hysi, Mirosh Bogdo, Teuta Qatipi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit tw Cilwsisw Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT